

Dialektika e Hegelit

Keqkuptimi dhe Zbatimi i Drejtë i Parimevet

grc. διαλεκτική dialektiké (dialektikë) – arti i argumentimit nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve interaktive. Fjala vjen prej, grc. διαλεκτικός dialektikós (debatues kompetent) < διαλέγομαι dialégomai (me marrë pjesë në dialog) < διά diá (ndër, nëpërmjet) + λέγειν légein (me folë).

Abstrakti

Termi ‘dialektikë’ përshkruan një metodë argumentimi që përfshin një proces ballafaqimi mes dy anëve me pikëpamje të përspekta (G. të kundërta). Synimi është që përmes këtij procesi të arrihet në përfundime më të thelluome. Për Platonin, dialektika është e kundërta e retorikës, të cilën ai a kupton si art sipërfaqësor; për Aristotelin, dialektika është arti i argumentimit që përdoret me kërkua të vërteta universale. Kjo e dallon atë prej retorikës, e cila mbetet e varun prej audiencës.

Ka një dallim thalbsor në mes dialektikës hegeliane dhe asaj platonike. Ndërsa te Platoni kundërshtia varet prej vullnetit të debatuesve (aspekti arbitrar), në dialektikën hegeliane kundërshtia buron prej vetë brendësisë së koncepteve. Prejse destabilizimi i konceptit rrjedhë prej kundërshtisë që përmban vetë koncepti, jo prej një debatuesi të jashtëm, ky proces i domosdoshëm i shtyn idetë drejt një faze më të përparuome. Për këtë arsye, Hegeli e quan sistemin e tij ‘Shkenca e Logjikës’, kurse dialektikën e platonit, ‘Dialektikë Arbitrare’.

Fjalët kyçe: *Dialektika hegeliane, tezë, kundërtezë, sintezë, triada e Hegelit, progresi i argumentit, Aufheben (Tejkalimi), alfa, beta, gama, dialektika platonike*

Dialektika vs. enthemimën. vs. silogjizmin

Gjuha na jep mundsinë me thanë diçka, *retorika* me ndikua mbë një audiencë, *logjika* me qenë të arsyeshëm, kurse *dialektika* i përmbledhë të gjitha këto duke kërkua që ne të jemi të qartë (gjuha) dhe të bindim audiencën (retorika); por me logjikë, jo dredhí. Prandaj, jo si në retorikë ku caku është me bindë audiencën, në dialektikë forca e argumentit provohet kur ai u qëndron kundër-argumenteve.

Dialektika, enthemima, dhe silogjizmi, kanë huazuom prej njëna-tjetrës aspekte si *evidenca* dhe *arsyetimi*. Por, ndryshimet në mes tyne ngulmojnë.

Silogjizmi bazohet në trí propozime (aserta, deklarata); dý premisa dhe një përfundim.

Tradicionalisht, kjo është metoda deduktive e logjikës (ose argumentit formal). Si-logjizmi i një logjicisti vlersohet ose kritikohet prej logjicistëve të tjerë.

Dialektika hegeliane bazohet në koncepte që shuajn dhe ruajn (mohojnë dhe pohojnë) vetveten. Kjo mostër argumentimi filozofik zhvillohet në mjedise akademike dhe vlersohet prej dialektistëve.

Enthemima është një silogjizëm i cinguom. Asaj i mungon njëna njëna premisë, ose mërallë përfundimi. Enthemima zhvillohet në ambiente publike, p.sh., në një park, në qendër të qytetit, para votuesve, në një program televiziv, etj. Kritikët ose vlersuesit e enthemimës janë masat e gjana, p.sh., votuesit ose juria në një gjykim.

Dialektika Hegeliane

Dialektika hegeliane përshkruan një metodë argumentimi filozofik të bazuome në tri *faza a momente*, ku konceptet përmbajnë edhe pohimin edhe mohimin e vetvetes (shuomjen dhe ruajtjen).

Në paragrafin 79, në *Shkenca e Logjikës* (ShL), Hegeli shkruan, “Përsa i përket formës, logjika ka tri faza, të cilat janë momente të çdo koncepti a të vërtete, por jo pjesë të logjikës”.

Disa mendimtarë i quajn fazat e dialektikës hegeliane ‘teza, antiteza, sinteza’, por këto terma nuk përdoren prej Hegelit, dhe mendimtarë të tjerë i shohin ato si errtare. Po ashtu, disa përdorin termin ‘fazë’ në vend të termit ‘anë’.

Shpjegimet pasuese janë të nevojëshme:

- Kur flitet për ‘fazat’ flitet për ‘të kuptuom’, jo për përkufizime.
- Emëni prejjesor ‘të kuptuom’ shenjon një proces mendor, kurse emëni i prejardhun ‘kuptim’ shërben si një etiketë. Prandaj termi ‘kuptim’ nuk do të përdoret.
- shqisimi (en. perception) imediat – *shqisim direkt* (kapet prej shqisave)
- shqisimi mediat – *shqisim me anë të diçkaje* (nuk kapet me anë të shqisave); mund të kuptohet me anë të arsytimit
- *Konceptet, abstraksionet, Kenja*, e të tjera nuk mund të përkapen me anë të shqisave sepse ato nuk egzistojnë në formë materiale. Egzistenca e tyre kapet me anë të arsytimit.
- Kenje/a – jeta që egziston në çdo qenje.
- qenje/a – cialdo qenje që mund të shqisohet: njeri, kafshë, shpend, insekt, guralec, etj.

α Faza I^ë – abstraksioni dhe të kuptuomit stabël

Kjo është faza e të kuptuomit të qëndrueshëm, të fiksuom, ose stabël; të të kuptuomit absolut ose *të njëanëshëm*. Këtu Hegeli nisë me një abstraksion universal, çka është e kundërta e të veçantës, e imediacionit ose e shqisimit (përceptimit direkt). Egzistenca e këtij abstraksioni as nuk kushtëzohet prej diçkaje tjetër as nuk përkufizohet në lidhje me diçka tjetër, domethanë, ajo është e paskajuome, nuk mund të skajohet, nuk mund t’i vëhen skaje ose kufij; është si paskajorja. Krahaso *me pasë* vs. [ti] *të kesh*.

Kur thona *Kenja*¹ është *Absolute*, Kenja merret për prezencë puro, ku ‘puro’ do të thotë e njohunive mendore, abstrakte; Ajo nuk mund të shqisohet. Egzistencën e Kenjes ne e kapim nëpërmjet mendjes; arsytimit a logjikës. Por kjo është një fazë që, siç u tha më nën, nuk është pjesë e logjikës.

Në këtë fazë, të *kuptuomit* ose koncepti duket i plotë dhe i stabilizuar sepse ai del i paskajuar. Si i tillë, përkufizimi i matejshëm i tij do të ishte i pamundur. Prandaj, nuk mund të hidhet dyshim mbë të.

Deri këtu, të *kuptuomit* mbetet si i tillë dhe nuk mund të përkufizohet sepse përkufizimi do ta skajonte skajonte atë. Por, le ta vendosim këtë të *kuptuom* në form propozimi a aserte:

Kenja është absolute.

Duke e deklarua atë në formë propozimi ne kufizojmë të *kuptuomit* e këtij koncepti dhe e dallojmë atë prej të tjerëve. Skajimi e zhveshë konceptin prej absolutizmit; mundson hedhjen e dyshimit a skepticizmit mbë konceptin absolut. Është ky skepticizëm që nevojisht, e shtyn të *kuptuomit* në fazën e dytë.

β Faza e II^{të} – Dialektike ose negativisht racionale; destabilizimi

Faza e dytë është faza dialektike, të cilën disa, errtisht, mund t’ua quajnë ‘antiteza’, dhe po errtisht, mund të mendojnë që kundërshtia vjen prej një entiteti tjetër. Kjo është e vertetë në dialektikën e Platonit, por jo të Hegelit.

Në dialektikën e Hegelit, kundërshtia përmbahet prej vetë konceptit.

Prejse në fazën e parë koncepti u pat skajuar, dhe si rezultat ky skajim pati mundsuom dyshimin, në fazën e dytë hidhet dyshim mbë të *kuptuomit* e fazës së parë. Dyshimi e çliron këtë fazë prej të *kuptuomit* të fiksuom a të njëanëshëm; paskajimit a paskajores. Kështu të *kuptuomit* e stabilizuar (faza e parë) kalon në destabilizim (faza e dytë). Edhe të *kuptuomit* e dytë është racionale si të *kuptuomit* e fazës së parë, por ka kuptim të kundërt. Termi ‘negativisht racionale’ përdoret me tregua sesi të *kuptuomit* e fazës së dytë lidhet me të *kuptuomit* e fazës së parë.

Por, duhet mbajtur në mendje që, sipas Hegelit, fazat a momentet i përkasin dialektikës, jo logjikës. Megjithatë, të dyja janë racionale.

Faza e parë: *Kenja është absolute.*

Faza e dytë: *Kenja është asgjë.* (nuk është absolute)

¹ Kenje – Ajo që u jep jetë (egzistencë a qenje) qenjeve individuale; nisë me germë të madhe; përdoret vetëm në njëjës. qenje – çfardo qenieje e veçuar prej botës, p.sh., një frut, një dele, një ujk, një njeri, etj.; përdoret edhe në shumës, dhe shkruhet me ‘q’ të vogël.

Termi gjerman që Hegeli përdorë këtu është ‘aufheben’. Në anglisht, ky term përkon me termin ‘*sublate*’. Por, në këtë kontekst, ky term merr formën ‘self-sublation’. Në shqip, ky term mund të kuptohet si ‘*me shua dhe me ruajt*²’ në të njëjtën kohë. Për shembull, të kuptuomit stabël (Kenja është absolute.) **shuhet** në fazën e dytë (Kenja është asgjë.). Por, absolutja (faza e I^{te}) **ruheth** si kundërshtí kundër asgjasisë në fazën e II^{te}; kundërshtia nuk mund të egzistojë pa u kundërshtuom.

Shuomja dhe ruajtja nuk duhen kuptua si aspekte aktive të fazës së dytë. Ato përmbahen në fazën e parë, ku të kuptuomit është i njëanëshëm. Është njëansia e të kuptuomit në fazën e parë ajo që, nevojshisht, e destabilizon këtë koncept; domethanë, të kuptuomit e fazës së parë përmban destabilizimin e vetvetes. Kështu, të kuptuomit e fazës së parë del në fazën e dytë si kundërshtí (en. opposite) e vetvetes.

Hegeli shkruan, “Por kur parimi dialektik dobisohet prej të kuptuomit ndashëm (i kufizuom; shih alpha) dhe pavarshëm... dialektika bëhet dyshim/skepticizëm; ku rezultati që pason jepet si mohim (negativitet) i thjeshtë. Kjo, vazhdon Hegeli, është natyra dhe esenca e çdo gjëje të predikuome prej të kuptuomit të thjeshtë.

Tendenca me u paraqitë në të kundërtën është në natyrën e të kuptuomit të njëanëshëm.

Ky aspekt i dialektikës hegeliane është thalbsor sepse kundërshtia përmbahet në vetë propozimin e dhanun; ajo nuk vjen as prej një entiteti tjetër as nuk është një idé tjetër; ajo përmbahet në të kuptuomit e njëanëshëm të fazës alfa; krejt ndryshe prej dialektikës arbitrare (Hegel) të Platonit. Nevoja e konceptit me kalua në të kundërtën e vetvetes tregon lëvizje, veprimtarí; për disá edhe progres.

Me shpjegua konceptin a dialektikës negative (beta) Hegeli përdorë konceptin e jetës dhe vdekjes. Qenja që *jeton dhe vdes*, nuk përmban dý cilsí speciale; jetën dhe vdekjen. Për Hegelin, *jeta-si-jetë* përfshin edhe *vdekjen-si-vdekje*. Jeta përmban vetshuomjen e saj; vdekjen. Po ashtu, edhe predikati i propozimit në alfa përmban vetshuomjen e tij.

Qenja jeton.

[Por jeta përmban virusin e vdekjes. Prandaj,]

Qenja vdes.

Në vend të të qenunit e qendrueshme ose ultimate (paskajore, pa skaj), gjithçka është e ndryshueshme dhe kalimtare (skajore, me skaj). Dhe kjo është egzaktisht çka nënkuptohet kur thona ‘Dialektika e skajores (en. dialectic of the finite); gjithçka është e skajuome; ka skaj. Me këtë kemi parasysh që, në brendsi, gjithçka është e ndryshëme prej dukës së saj.

² **Shënim:** Këtu mund të shihet se përse ‘me shua’ dhe ‘me ruajt’ nuk mund të zëvendsohen me ‘të shuash’ dhe ‘të ruash’, sepse ndërsa të parat janë përgjithsime, të dytat përdoren jo vetëm në lidhje me një person, por edhe kërkojnë komplemente (plotës) ‘të shuash çka?’ ose ‘të kuptosh çka?’. Por, imagjinoje sa errtisht do të tingllonin këto koncepte në formën e pseudo-paskajores: për të shuar dhe për të ruajtur.

Për shembull, në dukë jeta është jetë, por në mbrendsi jeta përmban edhe virusin e vdekjes. Dhe është vdekja që e detyron jetën me dalë jashtë skajsisë së saj imediate³ ose natyrale. Duke përmbajtë të kundërtën e vetvetes jeta zëvendsohet detyrimisht prej vdekjes.

Me tregua lidhjen e gramatikës me logjikën, këtu mund të feskohet dallimi funksional i *paskajores prej lidbores* dhe *pseudopaskajores*. E para nuk skajohet, nuk merr mbaresa: *me luajt*. Prandaj, ajo shtrihet në të tri aspektet e kohës dhe aplikohet te të tria vetat njëherazi. E dyta skajohet: (ti) *të luash*. Pa i shtua ndonjë fjalë tjetër, kjo formë (faktikisht flet për të ardhëmen, Topalli) dhe lidhet me vetën e dytë, njëjës. Kurse e treta, *për të luajtur*, në mënyrën sesi ajo përdoret, asht absurditet gramatikor. Verbalet nuk marrin parafjalë. Çka pason parafjalën ‘për’, është emën jo verbale (formë e pashtjelluome e foljes).

Hegeli e quan dialektikën e tij *Shekna e Logjikës* sepse kjo dialektikë ka në brendsi *nevojën e transformimit* (destabilizimin), kurse dialektika e Platonit, thotë Hegeli, jo vetëm që nuk ishte shkencë, por ajo ishte *arbitrare* dhe i merr idetë prej jashtë; nuk i vetprodhon. Për shembull, kur Sokrati, personazhi kryesor i dialogjeve të Platonit, deklaroi diçka, atij i duhet me pritë derisa dikush ta kundërshtojë premisën e tij. Fakti që Sokrati mund të mos ketë kundërshtarë, e ban këtë lloj dialektike arbitrare sepse kundërshtia varet te vullneti i të tjerëve. Mâ tej, duke ardhë prej të tjerëve, idetë kundërshtuese vinë prej jashtë; jo prej brenda si në dialektikën e Hegelit.

Nëpërmjet shembujve pasues, Hegeli tregon sesi të kuptuomit e fazës së parë kthehet në të kundërtën e vetvetes.

- Krenaria vjen para ramjes
- Urtsia e tepërt tejkalon vetveten.
- Ekstremet e dhimbjes dhe kënaqsisë kalojnë në njana-tjetrën.
- Zemra e tejnqarkuome me gëzim, lehtsohet prej lotëve.

Hegeli jep edhe disa shembuj që tregojnë *çka dialektika nuk është*.

- Dialektika nuk është art aventure. Kontradikta duhet të jetë e vërtetë, jo sipërfaqësore.
- Dialektika nuk është reflektim; largim prej një situatë.
- Dialektika nuk është sofizëm.
- Anarkia dhe despotizmi nuk janë dialektike. Ato nuk janë të kundërtat e njëna tjetrës sepse ato çojnë në njëna-tjetrën.

y Faza e III^{te} – Spekulative ose pozitivisht racionale; uniteti i të kundërtave

Tipikisht dy premisa që kundërshtojnë njëna-tjetrën e reduktojnë argumentin në absurditet (reductio ad absurdum). Por, megjithëse faza e tretë bazohet në dy fazat para saj, të

³ 1. Në filozofi: rreth dijes ose kundërveprimi – që fitohet ose tregohet pa nevojë arsyetimi; intuitivisht. 2. Mâ e afërta në kohë, marrdhanje, ose rend. 3. Që ndodhë menjëherë/

cilat kundërshtojnë njëna-tjetrën, Hegeli e shikon fazën e tretë si të pavarun sepse **gama** (faza e III^{te}) kapë *unitetin e kundërshtive* në **alfa** e **beta**; pohuesen (*afirmuesen*) në *alfa* dhe shpërbamjen e saj në mohim të vetvetes (*negativen*) në *beta*. Në dialektikën e Hegelit, egzistenca e këtyne opozitave—të kuptuomit në alfa dhe negativiteti në beta—janë provë e egzistencës së të vërtetës spekulative, përndryshe do të mbeteshim vetëm me të kuptuomit e njëanëshëm në fazën alfa.

Problemi me simetrinë

Niçi na paralajmëronte të mos e vëremjë natyrën si makinë. Heidegger ishte kundër çdo ideje që natyra njerzore mund të dhogaritet. Po t'a vëremjë me vmendje dialektikën, do të shohim që ajo ka natyrë simetrike, p.sh., të kuptuomit e fazë së parë, si në *Kenja është absolute*; *Kenja është kudo* mbrapshtkthehet në fazën e dytë, si në *Kenja është asgjë*; *Kenja s'është kund*.

Problemi me këtë simetri është që ajo nuk pasqyron natyrën njerzore. Njeriu nuk mendon simetrikisht sepse abstraksioni puro, mendimi pa ndikime të tjera, veçsisht emocionale, është i pamundun. Prandaj, është e vështirë të argumentohet që shkenca e të menduomit egziston. Por, ky paralajmërim përmbahet në vetë dialektikën. Ajo vetë na lejon ta kundërshtojmë atë. Kjo është filozofia perëndimore; e hapun. Sot ka shumë doktrina që nuk bazohen në logjikë (grc. logos) dhe mbeten në fazën e parë; janë të njëanëshme dhe vazhdojnë të merren si të tilla.